



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 277 prot.

Tiranë më, 18.02.2025

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr. 02, datë 18.02.2025

PËR

**“MASAT ADMINISTRATIVE DHE PROCEDURALE NË PROKURORITË ME
JURIDIKSION TË PËRGJITHSHËM NË PERIUdhËN PARA DHE PAS
ZGJEDHJEVE¹”**

Në mbështetje të neneve 148 e 148/b shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 38, pika 2, shkronjat “b” e “f”, nenit 46, pika 3, shkronja “ç”, 42, 43, 107/1, të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

UDHËZOJ:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim i përgjithshëm ka për qëllim unifikimin e masave në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm për rritjen e efektivitetit të hetimeve dhe ushtrimit të ndjekjes penale ndaj autorëve të veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve si dhe të veprave penale të tjera që dëmtojnë procesin zgjedhor, në periudhën para dhe pas

¹ Në përputhje me nenin 2, pika 23 të Kodit Zgjedhor, “Zgjedhje” janë votimet për Kuvendin, për njësitë e qeverisjes vendore dhe referendumet.

zgjedhore, për parandalimin e përgjithshëm të veprimtarisë kriminale në këtë fushë si dhe për verifikimin e integritetit të personave/kandidatë për t'u zgjedhur.

Neni 2 Objekti

Ky udhëzim i përgjithshëm përcakton masa të unifikuara për:

- a) organizimin dhe funksionimin e seksioneve të posaçme kundër krimit zgjedhor, si dhe kriteret e përzgjedhjes së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në përbërje të tyre;
- b) organizimin e gatishmërisë së përforcuar në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhjeve;
- c) hetimin dhe ndjekjen penale me përparësi dhe me efikasitet të veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, si dhe të çdo veprave penale tjetër që dëmton procesin zgjedhor;
- ç) bashkëpunimin dhe koordinimin me shërbimet e policisë gjyqësore;
- d) mënyrën e sigurimit të informimit në kohë për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve dhe për veprat e tjera të rënda kriminale të lidhura me to;
- dh) trajtimin e kërkesave të KQZ-së lidhur me verifikimin e integritetit të personave që janë kandidat për t'u zgjedhur;
- e) informimin KQZ-së dhe informimin e publikut dhe mediave për veprimtarinë e prokurorisë lidhur me hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve, që nuk cenon sekretin hetimor².

Neni 3 Përkufizime

Në këtë udhëzim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) "Prokurori me juridiksion të përgjithshëm" janë prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, prokuroria e apelit dhe Prokuroria e Përgjithshme;
- b) "Periudhë para dhe pas zgjedhjeve" është periudha që fillon me hapjen e fushatës zgjedhore, vijon me ditën e zgjedhjeve dhe përfundon me shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve nga KQZ-ja;
- c) "Dita e zgjedhjeve" është data e votimit e caktuar me dekret të Presidentit të Republikës³;
- ç) "Hapja e fushatës zgjedhore" fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve;
- d) "Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve" është rezultati i shpallur nga KQZ-ja në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor;

² Shih nenet 103, 279 të Kodit të Procedurës Penale

³ Me dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në datë 11 Maj 2025, zhvillohen zgjedhjet për Kuvendin.

- dh) “Zgjedhje” janë votimet për Kuvendin, për njësitë e qeverisjes vendore dhe referendumet;
- e) “Zgjedhje të pjesshme” janë votimet për të plotësuar vendin e kryetarit të bashkisë, si dhe për zgjedhjen e një këshilli të ri vendor në rast shpërbërje;
- ë) “KQZ” është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili është institucioni shtetëror i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor;
- f) “KZAZ” është Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, që ngrihet dhe funksionon në përputhje me Kodin Zgjedhor, për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë dhe zgjedhjet vendore.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SEKSIONEVE TË POSAÇME NË PROKURORI

Neni 4

Krijimi i seksioneve të posaçme të përkohshme

1. Drejtuesit në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, krijojnë seksionin e posaçëm kundër krimit zgjedhor me përbërje prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve të prokurorisë dhe oficerë të policisë gjyqësore të shërbimeve të Policisë së Shtetit, i cili do të funksionojë deri më datë 31.05.2025.
2. Drejtuesi i prokurorisë, drejton seksionin e posaçëm dhe përgjigjet për hetimin e veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve të cilat janë në kompetencë të prokurorisë që drejton⁴.
3. Përzgjedhja dhe caktimi i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve nga drejtuesi i prokurorisë, si rregull, për aq sa është e mundur, bazohet në kriteret si vijojnë:
 - a) të kenë eksperiencë në punë jo më pak se 4 vjet ose eksperiencën më të gjatë në punë dhe/ose;
 - b) të kenë eksperiencë ose të kenë marrë pjesë në trajnime për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve;
 - c) nuk mund të jenë pjesë e seksionit personat për të cilët ekzistojnë, ose dalin më pas shkaqe të rëndësishme njëanshmërie si dhe në rastet e parashikuara në nenet 16 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale;
4. Organizimi i shërbimeve të policisë gjyqësore në funksion të caktimit në seksionin e posaçëm, të mbështetur nga grupet operacionale, dhe mbështetja me kapacitete teknike

⁴ Shih nenin 43, shkronja “c” të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar.

do të bëhet sipas marrëveshjes së Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

5. Krijimi i seksioneve të posaçme dhe caktimi i prokurorëve kryhet brenda dhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

Neni 5

Shpërndarja e çështjeve për ndjekje

1. Prokurorët e seksionit do të vijojnë të ushtrojnë funksionet edhe në seksionin e përhershëm ku janë caktuar.
2. Gjatë periudhës së funksionimit të seksionit të posaçëm, shpërndarja me short e çështjeve që lidhen me krimin zgjedhor do të kryhet vetëm ndërmjet prokurorëve të seksionit të posaçëm, pavarësisht organizimit të gatishmërisë.
3. Drejtuesi i prokurorisë, njihet me ngarkesën në hetim të çdo prokurori dhe vlerëson ndryshimin e raportit të ndarjes së çështjeve ose përjashtimin nga shorti të prokurorëve të caktuar pranë seksionit të posaçëm kundër krimin zgjedhor.

KREU III

HETIMET DHE NDJEKJA PENALE

Neni 6

Masat për organizimin dhe funksionimin e gatishmërisë

1. Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm drejtuesit e prokurorive marrin masat e nevojshme për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të gatishmërisë në periudhën para dhe pas zgjedhore duke dyfishuar numrin e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të gatshëm.
2. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të caktuar në gatishmëri, duhet të garantojnë disponueshmërinë e tyre në çdo kohë për zgjidhjen e çështjeve të ngutshme dhe të jenë të arritshëm në çdo moment nga strukturat e seksioneve dhe/ose shërbimeve të policisë gjyqësore.
3. Drejtuesit e prokurorive të shkallës së parë, bëjnë publik grafikun e gatishmërisë dhe numrat e kontaktit të vendosur në dispozicion dhe ia njoftojnë Prokurorisë së Përgjithshme dhe strukturave të shërbimeve të policisë gjyqësore.

Neni 7

Kryerja e hetimeve proaktive

1. Me marrjen dijeni për vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, prokurori në prokurorinë pranë gjykatës kompetente, pasi vlerëson ekzistencën e kushteve/kritereve ligjore përkatëse, vendos regjistrimin e procedimit penal dhe bashkërendon me agjencitë ligjzbatuese të specializuara për kryerjen e

hetimeve proaktive, duke përdorur mjetet e posaçme të hetimit.

2. Prokurori në respektim të procedurës ligjore autorizon ose mbi kërkesën e tij me vendim gjyqësor autorizohet përdorimi i mjeteve të posaçme të hetimit, ashtu dhe nëpërmjet lënies së detyrave oficerëve të policisë gjyqësore dhe kontrollit/mbikëqyrjes të zbatimit të tyre, mundëson, si parandalimin dhe/ose ndërprerjen e mëtejshme të veprimtarisë kriminale, ashtu dhe goditjen/finalizimin me arrestimin në flagrancë apo ndalimin e personave të përfshirë në kryerjen e veprave penale në këtë fushë.

Neni 8

Mbikëqyrja gjatë ecurisë së çështjeve

1. Drejtuesi i prokurorisë në momentin e caktimit të procedimit/çështjes për vlerësim/ndjekje prokurorit përkatës, për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, kur e vlerëson të nevojshme për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit/çështjes, nxjerr udhëzim jo të detyrueshëm me shkrim për prokurorin përkatës, për kryerjen e detyrave specifike për të garantuar një hetim të plotë e të gjithanshëm në kuadrin e një procedimi të drejtë dhe të rregullt ligjor.
2. Drejtuesi i prokurorisë ndjek në dinamikë veprimtarinë e procedimeve për grupveprat penale në fushën e zgjedhjeve, duke kërkuar informacion nga prokurorët për ecurinë e procedimeve dhe verifikuar përfundimin e secilës çështje, dhe/ose duke nxjerrë udhëzime me shkrim sipas ligjit në rastet kur vlerësohet e nevojshme kryerja e veprimeve të mëtejshme procedurale përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake nga prokurori.
3. Drejtuesi i prokurorisë, siguron koordinimin e punës me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe dispozitave të këtij udhëzimi, si dhe për zbatimin e angazhimeve të ndërmarra në Protokollin e Koordinimit ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Neni 9

Hetimi, ushtrimi i ndjekjes penale, ngritja dhe përfaqësimi i akuzës në gjyq

1. Prokurorët vlerësojnë dhe trajtojnë me prioritet çdo referim apo kallëzim për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve ose të çdo vepre tjetër penale që dëmton procesin zgjedhor.
2. Pas regjistrimit të procedimit penal, prokurori i delegon oficerëve të policisë gjyqësore kryerjen e veprimeve hetimore të nevojshme, duke përcaktuar afate kohore të përshpejtuara, si dhe mbikëqyrin në vijimësi zbatimin e urdhërimeve të tyre, deri në përfundim të hetimeve paraprake. Vëmendje e veçantë t'i kushtohet ruajtjes së provave që mund të ndryshojnë ose të humbasin me kalimin e kohës dhe marrjes në kohë të të

- dhënave nga kallëzuesit dhe personat që kanë dijeni për rrethanat e ngjarjes.
3. Prokurorët të kryejnë me përparësi veprimet procedurale për të siguruar: -hetime të plota dhe gjithëpërfshirëse të çështjeve; -ngritjen e akuzës në gjykatë bazuar në rrethanat e faktit të provuara dhe në ligjin material penal e procedural penal të zbatueshëm; -përfaqësimin e akuzës/çështjes në gjykatë me pavarësi, profesionalizëm dhe integritet, duke garantuar mbrojtjen e zgjedhjeve të lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, ashtu dhe liritë personale dhe interesat e ligjshme të shtetasve.
 4. Prokurorët nxiten të ndjekin një politikë penale rigoroze lidhur me kërkesat për caktimin e masave të sigurimit personal dhe kërkesat për masë dënimi, për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve ose të çdo vepre tjetër penale që dëmton procesin zgjedhor.

KREU IV BASHKËPUNIMI

Neni 10

Bashkëpunimi me Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

1. Prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm sigurojnë koordinim të shpejtë dhe efektiv për hetimin e rasteve, me Prokurorinë e Posaçme duke shkëmbyer informacion të plotë, në mënyrë të shpejtë dhe të sigurtë për veprat penale në fushën e zgjedhjeve dhe autorët e tyre.
2. Prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm sigurojnë kalimin dhe/ose tërheqjen e akteve drejt/prej Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në një kohë sa më të shpejtë dhe duke siguruar efektivitetin dhe vazhdimësinë e hetimeve proaktive në rastet kur gjatë hetimit evidentohen subjekte ose vepra penale për të cilët prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm nuk kanë kompetencë lëndore.
3. Drejtuesi i prokurorisë, me cilësinë e drejtuesit të seksionit, ngarkohet si pikë kontakti me Prokurorinë e Posaçme për një komunikim sa më efektiv gjatë periudhës zgjedhore.
4. Prokurori i Përgjithshëm dhe/ose drejtuesi i prokurorisë, organizojnë zhvillimin e takimeve të përbashkëta për vlerësimin e ecurisë së bashkëpunimit dhe adresimin e çështjeve të nevojshme.

Neni 11

Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit dhe agjensitë e tjera ligjzbatuese

1. Prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm sigurojnë bashkëpunim dhe koordinim me Policinë e Shtetit, sipas angazhimeve të marra përsipër në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit "Për marrjen e masave efektive kundër krimeve zgjedhore"(aneksi i

këtij udhëzimi).

2. Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm shkëmbejnë informacione, si me shërbimet e policisë gjyqësore në Drejtorinë dhe/ose Komisionin vendor përkatës, ashtu dhe me agjencitë e zbatimit të ligjit dhe shërbimet inteligjente, për të marrë dijeni menjëherë për vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve apo për veprat penale të tjera që dëmtojnë procesin zgjedhor, duke garantuar ruajtjen e sekretit hetimor dhe ndalimin e publikimit të akteve sipas ligjit.

Neni 12

Bashkëpunimi me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

1. Prokuroritë bashkëpunojnë me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve apo organizata të tjera në kuadër të fushatave informuese për publikun për të njohur sjelljet që përbëjnë vepra penale në fushën e zgjedhjeve, për të rritur ndërgjegjësimin mbi pasojat ligjore të kryerjes së krimeve zgjedhore dhe rëndësinë e raportimit të tyre.
4. Prokurorët në përputhje me detyrimet procedurale, i njoftojnë KQZ-së vendimarrjen përkatëse në rastet kur ka bërë kallëzim penal brenda dy ditëve nga marrja e vendimit.
5. Prokurori i Përgjithshëm cakton një prokuror dhe një oficer të policisë gjyqësore, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, gjatë gjithë procesit, për koordinim të pandërprerë dhe sistematik me prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, në përputhje me angazhimet e Protokollit të Koordinimit ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Prokurori i Përgjithshëm ngarkon një prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme si pikë kontakti për dhënien e informacionit KQZ-së⁵ për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve në kompetencë lëndore të juridiksionit të përgjithshëm, duke garantuar ruajtjen e sekretit hetimor, ndalimin e publikimit të akteve dhe mbrojtjen e të dhënave personale sipas përcaktimeve ligjore. Informacioni përmban të dhëna/tregues për procedime/çështje penale, si vijon:
 - a) të regjistruara për vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve;
 - b) numrin e personave nën hetim dhe/ose të pandehurve;
 - c) kohëzgjatjen e hetimit dhe përfundimin e tij;
 - ç) numri i kërkesave të prokurorisë për gjykim, sipas mënyrës së përfundimit të hetimeve;
 - d) kohëzgjatjen e gjykimit dhe përfundimin e tij;
 - dh) çështje të gjykuara dhe disponimi i gjykatës në vendim;
 - e) ankimet ndaj vendimeve gjyqësore, shkaku i ankimit dhe çfarë kërkohet;
 - ë) të gjykuara në apel dhe disponimi i gjykatës në vendim;
 - f) rekursitet ndaj vendimeve gjyqësore të apelit, shkaku i rekursit dhe çfarë kërkohet;

⁵ Shih nenin 107/1 të ligjit nr. 97/2016, të ndryshuar

- g) të gjykuara në Gjykatën e Lartë dhe disponimi i gjykatës në vendim;
- gj) vendime të formës së prerë ndaj të dënuarve të urdhëruara për ekzekutim dhe të ekzekutuara.

Neni 13

Raportimi periodik në prokurori dhe informimi i publikut dhe medias

1. Prokurori për marrëdhëniet me publikun, nën mbikëqyrjen e drejtuesit të prokurorisë, përpilon raportin 24 orësh për veprimtarinë e të gjithë prokurorëve për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve dhe për çdo vepër penale tjetër që dëmton procesin zgjedhor.
2. Prokurori për marrëdhëniet me publikun të gjitha informacionet e nevojshme, që nuk cënojnë ruajtjen e sekretit hetimor dhe ndalimin e publikimit të tyre, duhet t'ja dërgojë prokurorit ose personelit të caktuar pranë Drejtorisë së Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme, i cili i përditëson dhe i publikon në faqen zyrtare të prokurorisë (www.pp.gov.al).
3. Raporti periodik njëzetë e katër orësh duhet të përmbajë të dhëna për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve lidhur me:
 - a) ndalimet e personave me urdhër të prokurorit;
 - b) kërkesat për caktimin e masave të sigurimit "arrest në burg";
 - c) numrin e akuzave të ngritura dhe kërkesat për dërgimin e çështjes në gjyq;
 - ç) njoftime për kërkesat e prokurorëve në gjykatë dhe vendimet përkatëse gjyqësore që evidentojnë arritjet/rezultatet e prokurorisë;
 - d) raste e përcaktuara në nenin 8 pika 4 të këtij udhëzimi dhe rastet e tjera që vlerësohen se janë me interes për publikun.
4. Prokurori për marrëdhëniet me publikun harton raportin mujor bazuar në raportet periodike njëzetë e katër orëshe, për treguesit më sipër për këto grupvepra penale.
5. Me referimin nga policia gjyqësore në prokurori të veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, në momentin që prokurori urdhëron regjistrimin e procedimit penal, policia gjyqësore ndërpret çdo komunikim me publikun dhe mediat për të dhënat në atë referim, pa pëlqimin e prokurorit të çështjes dhe/ose prokurorit për marrëdhëniet me publikun.

Neni 14

Bashkëpunimin me publikun

1. Në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme në rubrikën përkatëse vihet në dispozicion format standard kallëzimi dhe informacion, për të lehtësuar/ftuar qytetarët të kallëzojnë shkeljet e ligjit që kanë cënuar interesat e tyre si zgjedhës ose të konstatuara prej tyre, në periudhën para zgjedhore dhe ditën e zgjedhjeve.
2. Prokuroritë marrin çdo masë të nevojshme për ndalimin e aksesit në regjistra dhe akte

dhe garantimin e mbrojtjes maksimale të konfidencialitetit apo çdo mbrojtje tjetër të nevojshme në përputhje me situatën, të çdo shtetasi që kallëzon një vepër penale në fushën e zgjedhjeve ose që lidhet me to.

KREU V

VERIFIKIMI I INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN

Neni 15

Verifikimi i integritetit të personave që zgjidhen

Spektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme trajton me prioritet kërkesat e KQZ-së për verifikimin e integritetit të personave kandidatë për t'u zgjedhur, kërkesa të shoqëruara me formularët e vetëdeklarimit dhe relacionin/dokumentacionin përkatës, për verifikimin e thelluar në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", në bashkërendim me prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm dhe me agjencitë e zbatimit të ligjit, si brenda vendit, ashtu dhe ato ndërkombëtare, për të shmangur zgjedhjen e atyre kandidatëve që i ndalohet të ushtrojnë funksione publike.

KREU VI

PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE, ZBATIMI, HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI

Neni 16

Shkeljet dhe përgjegjësia disiplinore

Shkelja e dispozitave ligjore referuese në këtë udhëzim të përgjithshëm dhe/ose moszbatimi i normimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, kur nuk përbëjnë vepër penale, mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas ligjit dhe/ose shkak për nisjen e verifikimeve nga Spektori i Monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme ndaj oficerit të policisë gjyqësore, prokurorit dhe/ose drejtuesit në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm.

Neni 17

Zbatimi dhe mbikëqyrja

1. Ky udhëzim i përgjithshëm është i detyrueshëm për zbatim nga drejtuesit e prokurorive, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm dhe shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit.
2. Me mbikëqyrjen e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohen drejtuesit e prokurorive dhe prokurori e personeli i caktuar pranë Drejtorisë së Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët për ecurinë e zbatimit të tij informojnë periodikisht Prokurorin e Përgjithshëm.

3. Drejtuesit e prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi.

Neni 18
Shfuqizime

Udhëzimi nr. 3, datë 21.06.2019 “Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhore”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 19
Hyrja në fuqi dhe publikimi

Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme.

PROKUROR I PËRGJITHSHËM

OLSIAN ÇELA

